



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 30213000-5 - Kompjuterat personale,  
30213300-8 - Kompjuterat desktop  
30230000-0 -Pajisje që lidhen me kompjuterat  
38651100-4 - Lente për kamera

VLERA E FONDIT LIMIT: **2,830,865** (dy milion e tetëqind e tridhjetëmijë e tetëqind e gjashëdhjetë e pesë) **lekë pa tvsh**, i detajuar:

- Këshilli Bashkiak me fondin limit prej 61,333 (gjashtëdhjetë e njëmijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë pa tvsh**;
- Drejtoria TIK me fondin limit prej 2,048,466 (dy milion e dyzet e tetëmijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) **lekë pa tvsh**;
- Drejtoria e të Ardhurave me fondin limit prej 99,933 (nëntëdhjetë e nëntëmijë e nëntëqind e tridhjetë e tre) **lekë pa tvsh**;
- Drejtoria e Kulturës me fondin limit prej 621,133 (gjashtëqind e njëzet e njëmijë e njëqind e tridhjetë e tre) **lekë pa tvsh**.

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i

vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*,

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

1. *Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2023, 2024 dhe 2025) lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës e përkatësisht **1,132,346 (një milion e njëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e dyzet e gjashtë) lekë.**

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” “*Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën*”.

*”Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”*, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/c, nenin 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe në kontratat*

me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedurë prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **1,132,346 (një milion e njëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e dyzet e gjashtë) lekë**, që është 40% e vlerës së fondit limit lotit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4, “Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

**2.2.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për vitin 2025 (Sipas QKB) si dhe këstet e maturuara për vitin 2026 sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në*

*formularin permblledhes te vetdeklarimit, sic kerkohet ne piken 2.2.2, duke dorezuar dokumentacionin original ose kopje te njesuara me originalin.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe ne ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr. 9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

*Megjense operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë jo më të vogël se 20 % fondit limit ne nje vlere prej **566,173 (pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë**, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe **furnizimet** e realizuara.
- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 20% të fondit limit.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të shërbimit të kërkuar objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar kontratë të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal të lejuar dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës është nën kufirin e ulët monetar, vlera për furnizime të ngjashme prej **566,173 (pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë** përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në **masën 20% të** fondit limit.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi/distributori i autorizuar për tregtimin e artikujve me rëndësi të veçantë me nr. Rendor: **1, 11; 2,3,6,12; 5**. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Ky kriter është përcaktuar në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe pikën 8 të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, duke marrë në konsideratë natyrën dhe kërkesat e objektit të prokurimit.

Duke qenë se objekti i procedurës është **“Blerje pajisje TIK”**, Autoriteti Kontraktor ka nevojë të sigurohet që pajisjet e ofruara janë produkte të identifikueshme, autentike dhe në përputhje me specifikimet teknike, si dhe që për to mund të sigurohen shërbimet e garancisë dhe mbështetjes teknike të kërkuara.

Për këtë arsye, kërkohet paraqitja e një **autorizimi të prodhuesit ose distributorit të autorizuar**, për pajisjet për të cilat është përcaktuar kjo kërkesë. Ky dokument i mundëson Autoritetit Kontraktor të verifikojë origjinën dhe kanalin e furnizimit të produkteve, si dhe të ketë siguri më

të madhe se operatori ekonomik ka akses në furnizimin dhe, sipas rastit, në shërbimet e garancisë dhe mbështetjes teknike për pajisjet e ofruara.

Kërkesa është veçanërisht e lidhur me natyrën e pajisjeve TIK, për të cilat përputhshmëria teknike, funksionaliteti, garancia dhe mbështetja pas shitjes janë elementë të rëndësishëm për përmbushjen e qëllimit të kontratës dhe vijimësinë e përdorimit të pajisjeve.

Ky kriter nuk synon të favorizojë një prodhues, markë apo operator ekonomik të caktuar, por shërben si një **mjet verifikimi për produktet dhe kanalin e furnizimit**. Për këtë arsye, autorizimi mund të lëshohet nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar, sipas organizimit të kanalit të furnizimit për produktin përkatës.

Në vlerësimin e Autoritetit Kontraktor, kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe proporcionale me nevojën për të garantuar furnizimin e pajisjeve TIK sipas specifikimeve teknike, si dhe përmbushjen e detyrimeve të garancisë dhe mbështetjes teknike gjatë zbatimit të kontratës.

Për sa më sipër, kërkesa për autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar konsiderohet e nevojshme dhe e justifikuar për realizimin e objektit të prokurimit, duke respektuar parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, konkurrencës dhe proporcionalitetit.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë, fletë teknike, link zyrtar të prodhuesit ose dokumentacion teknik për pajisjet e ofruara, të shënuara sipas numrit të artikullit në preventiv/specifikime.

*Katalogë, fletë teknike, link zyrtar të prodhuesit ose dokumentacion teknik për pajisjet e ofruara, të përmbajë karakteristikat teknike të produkteve që janë objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produktet e ofruar plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

**Argumentimi:** Ky kriter është përcaktuar në përputhje me nenin 36 i Ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar; neni 40, pika 2 dhe pika 3, i VKM nr. 285/2021, e ndryshuar, Pajisjet TIK objekt të prokurimit karakterizohen nga specifikime teknike dhe funksionale të cilat duhet të verifikohen në mënyrë objektive përpara vlerësimit të ofertave. Për këtë arsye, kërkesa për paraqitjen e katalogut teknik të prodhuesit ose të dokumentacionit teknik zyrtar me informacion të barasvlershëm i mundëson Autoritetit Kontraktor të identifikojë produktet dhe modelet e ofruara dhe të verifikojë përputhshmërinë e karakteristikave të tyre me kërkesat e përcaktuara në Specifikimet Teknike.

Specifikimet teknike përfshijnë parametra minimalë të performancës, lidhjes, memories, kapacitetit, rezolucionit, shpejtësisë dhe kompatibilitetit. Katalogët dhe fletët teknike janë dokumentet më të përshtatshme për verifikimin objektiv të përputhjes me kërkesat teknike dhe për shmangien e furnizimit me produkte që nuk plotësojnë funksionin e kërkuar.

Markimi i qartë i produktit/modelit dhe i specifikimeve përkatëse synon të lehtësojë procesin e vlerësimit dhe të sigurojë që përputhshmëria e ofertës të vlerësohet mbi bazën e dokumentacionit

technik të identifikueshëm dhe të verifikueshëm, duke shmangur paqartësitë lidhur me produktin e propozuar.

Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe synon të ulë riskun e furnizimit me pajisje që nuk përmbushin kërkesat teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Ajo nuk synon të favorizojë një prodhues, markë ose operator ekonomik të caktuar, pasi lejohet paraqitja e dokumentacionit teknik zyrtar të prodhuesit që mundëson verifikimin e kërkesave, pavarësisht markës apo prodhuesit.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për katalogun teknik është **e lidhur, e nevojshme dhe proporcionale me objektin e prokurimit**, pasi i shërben drejtpërdrejt verifikimit të përputhshmërisë së pajisjeve TIK të ofruara me specifikimet teknike dhe funksionale të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**2.3.4** Operatori Ekonomik Ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat perkatese të vlefshme (objekti i të cilave të jetë në përputhje me objektin e prokurimit), si mëposhtë:

ISO 9001 ose ekuivalente me SSH- mbi “Sistemet e menaxhimit cilësisë”,

*Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.*

**Argumenti:** Ky kriter është përcaktuar në përputhje me nenet **36, 77 dhe 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar**, si dhe me nenet **40 dhe 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar**, duke marrë në konsideratë natyrën, objektin dhe kompleksitetin e mallrave që do të prokurohen. Objekti i procedurës është **blerje pajisjesh TIK**, për të cilat është e rëndësishme që mallrat e furnizuara të jenë në përputhje me kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe që operatori ekonomik të ketë një sistem të përshtatshëm për menaxhimin dhe sigurimin e cilësisë së proceseve që lidhen me furnizimin e tyre.

Në këtë kuadër, kërkesa për paraqitjen e **certifikatës ISO 9001 ose ekuivalente**, të lëshuar nga një organ i akredituar i vlerësimit të konformitetit, synon të dëshmojë se operatori ekonomik zbaton një sistem të menaxhimit të cilësisë të certifikuar, i cili përfshin procese të dokumentuara për kontrollin dhe përmirësimin e cilësisë, menaxhimin e proceseve të furnizimit dhe sigurimin e konformitetit të produkteve dhe shërbimeve me kërkesat e përcaktuara.

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, pasi furnizimi i pajisjeve TIK kërkon respektimin e vazhdueshëm të specifikimeve teknike, kontrollin e proceseve të furnizimit dhe garantimin e konformitetit të mallrave të dorëzuara me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Kërkesa është përcaktuar duke respektuar parimet e **proporcionalitetit, transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës**, duke parashikuar pranimin edhe të certifikatave ekuivalente dhe duke mos e lidhur kërkesën me një subjekt certifikues, prodhues apo operator ekonomik të caktuar.

**2.3.5** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar, nëpërmjet së cilës deklarohet se: *Pranon dhe merr përsipër të përmbushë të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe kushtet e garancisë të përcaktuara në Specifikimet Teknike dhe në dokumentet e tenderit, për pajisjet objekt i kësaj procedure prokurimi, si dhe të gjitha detyrimet përkatëse gjatë ekzekutimit të kontratës, përfshirë detyrimet lidhur me riparimin, zëvendësimin dhe shërbimin gjatë periudhës së garancisë, sipas kushteve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Ky kriter është përcaktuar duke marrë në konsideratë objektin e procedurës së prokurimit, **“Blerje pajisje TIK”**, dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të VKM nr. 285/2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, dhe dokumentet standarde për procedurën e hapur të thjeshtuar për mallra.

Duke qenë se pajisjet TIK duhet të përmbushin kërkesa të përcaktuara teknike dhe funksionale dhe të jenë të mbuluara nga kushtet e garancisë dhe shërbimit pas shitjes, Autoriteti Kontraktor kërkon që operatorët ekonomikë të deklarojnë qartë pranimin dhe angazhimin për përmbushjen e këtyre kërkesave.

Deklarata synon të sigurojë që operatori ekonomik ka marrë dijeni për kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe angazhohet t’i respektojë ato gjatë ekzekutimit të kontratës, përfshirë detyrimet për riparimin, zëvendësimin dhe shërbimin gjatë periudhës së garancisë.

Kërkesa lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, zbatohet në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe nuk favorizon ndonjë prodhues, markë apo subjekt të caktuar. Ajo synon të shmangë paqartësitë gjatë zbatimit të kontratës dhe të sigurojë vijimësinë e funksionimit të pajisjeve TIK.

Detyrimet konkrete për garancinë, riparimin, zëvendësimin dhe shërbimin pas shitjes do të zbatohen gjatë ekzekutimit të kontratës, sipas specifikimeve teknike dhe kushteve të kontratës.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kjo kërkesë është **e lidhur me objektin e prokurimit, e nevojshme dhe proporcionale**, dhe është përcaktuar në respektim të parimeve të transparencës, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, konkurrencës dhe proporcionalitetit.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike të pajisjeve përkatëse janë hartuar nga një grup i ngarkuar me Urdher Titullari i A.K në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance,*



*apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*